



OJQ "Kasneçët e Ardhmërisë" – KeA është organizatë joqeveritare e cila zbaton projekte të ndryshme në fushën e shëndetit publik dhe fushat tjera shëndetësore. Ajo ka fituar mbështetje financiare nga Ministria e Shëndetësisë për projektin "Zbulimi aktiv i rasteve dhe ndërgjegjësimi i popullatës mbi TB në komunën e Obiliqit dhe Fushë Kosovës". Për qëllim të këtij projekti OJQ KeA shpall konkurs për këto pozicione:

1. Punëtor shëndetësor për zbulimin aktiv të rasteve -4 (katër- 2 në Obiliq dhe 2 në Fushë Kosovë) me kohëzgjatje për 8 muaj

Detyrat:

- Të bëjë edukimin shëndetësor të popullatës të përfshirë në aktivitet mbi TB
- Të informojë anëtarët e komunitetit për qëllimin e aktivitetit të zbulimit aktiv të rasteve
- Të sigurojë që të gjitha pyetësorët t'i kenë në numër të mjaftueshëm
- Të identifikojë rastet e dyshimta në komunitetin e përfshirë me aktivitete
- Të sigurojë që rastet e dyshimta të procedohen sipas politikave nacionale të TB
- Të sigurojë që personat e supozuar me TB të identifikuar të referohen me siguri në qendrat diagnositike të TB.
- Të bëjë regjistrimin e rasteve të dyshimta dhe të konfirmuara
- Detyrat tjera sipas nevojave të projektit

Kualifikimet:

- Të ketë të kryer edukimin në fushën e mjekësisë
- Të ketë njohuri elementare mbi TB
- Të zhvillojë dhe kontribuojë në punën ekipore
- Të jetë e gatshme për punën në teren
 - Patentë shoferi i dëshirueshëm

2. Edukatorë për trajnim e peer-peer trajnerëve për komunitetet në këto dy komuna

Detyrat:

- Të vëjë komunikimin me udhëheqësitë e komunitetit për përzgjedhjen e kandidatëve më të spikatur për tu trajnuar si peer-peer edukatorë
- Të përgadisë materialin e trajnimit
- Të udhëheqë trajnimin në bazë të principve të peer-peer edukatorëve
- Të dokumentojë mbajtjen e trajnimit me listën e trajnimit si dhe fotot nga trajnimi
- Të raportojë te udhëheqësi i projektit

Kualifikimet:

- Të ketë të kryer edukim formal në fushën e mjekësisë;
- Të ketë njohuri bazike mbi sëmundjen e tuberkulozit;
- Përvojë e mëparshme në implementimin e sesioneve edukative shëndetësore dhe peer to peer e dëshirueshme;
- Aftësi në përpilim e raporteve;
- Të jetë komunikativ dhe fleksibil me antarët e komunitetit.

Konkursi mbetet i hapur deri me 11 Maj 2023, në ora 12.00. CV-të të dërgohen në email-at: rinarexha28@gmail.com ose në zyrë të OJQ KeA. Vetëm lista e ngushtë e kandidatëve do të kontaktohet.